

KOMUNITETI/ASOCIACIONI I KOMUNAVE SERBE

"përmbledhja e të gjitha shqetësimeve"

Komuniteti/Asociacioni i
komunave Serbe:
Përmbledhja e të gjitha
shqetësimeve

Ky projekt është i përkrahur nga: Kosovo Foundation for Open Society (KFOS)
Mendimet, të dhënat dhe/apo përfundimet e dhëna në këtë publikim janë ato të autorëve dhe jo domosdoshmërisht reflektojnë pikpamjet e Kosovo Foundation for Open Society (KFOS)

Autorët: Branislav Nešović dhe Riccardo Celeghini

Copyright © Qershor 2015, AKTIV

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo me çfarëdolloj mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose ndryshe, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit.

Publikuar nga:

OJQ AKTIV
Čika Jovina 9/27, North City II/6, Mitrovica
Email: office@ngoaktiv.org
Web: www.ngoaktiv.org

Përmbajtja:

Përmbledhja	I
Rekomandimet.....	III
Hyrja – Përmbledhja e të gjitha shqetësimeve.....	1
Marrëveshja e Brukselit	3
Themelimi i KKS: Interpretime Kontradiktore dhe pritjet.....	7
- Pozita e Beogradit – Asgjë nuk është rënë në dakord para se çdo gjë t'bihet në dakord... 7	
- Pozita e Prishtinës – Së pari ne pajtohemi në çdo gjë dhe pastaj ne nuk mund të diskutojmë asgjë	11
- Pikëpamjet e komunitetit lokal.....	15
o Një proces teknik pa fytyrë njerëzore.....	15
o E tëra ka t'bëj me frikën	15
o Përceptimi dhe Pritjet	19
Përfundim.....	22
Bibliografia	24

Lista e shkurtesave:

AKK – Asociacioni i Komunave të Kosovës

KKS/AKS – Komunitetit/Asociacioni i Komunave Serbe

QQGj – Qendra për Qeverisje Gjithëpërfshirëse

SHEVJ – Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm

BE – Bashkësia Evropiane

QK – Qeveria e Kosovës

QS – Qeveria e Serbisë

K- Shqiptarë – Shqiptar të Kosovës

K-Serb – Serb të Kosovës

LDK – Lidhja Demokratike e Kosovës

OJQ – Organizata Jo Qeveritare

PDK – Partia Demokratike e Kosovës

MSA – Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

PPS – Partia Progressive Serbe

Srpska – Lista Serbe

Përmbledhje e përgjithshme:

Komuniteti/Asociacioni i komunave me shumicë serbe ka qenë një gur themel i Marrëveshjes së Brukselit. Sot, dy vjet pas nënshkrimit të marrëveshjes, sukseset fillestare të procesit janë dëmtuar seriozisht nga vonesa e krijimit të KKS/AKS-së. Së pari e paraparë për fundin e vitit 2013, krijimi i saj ende mbetet në ajër dhe është subjekt i mosmarrëveshjeve të shumta, argumenteve të ashpra, dhe keqinterpretimeve që rrjedhin nga të gjitha anët. Suksesi i Marrëveshjes së Brukselit dhe akomodimi i mëvonshëm i komunitetit serb në Kosovë është subjekt i zbatimit të suksesshëm të pikave të Marrëveshjes të cilat i referohen Komunitetit/Asociacionit të komunave me shumicë serbe. Pavarësisht këtij realiteti, asnjëra palë në këtë proces nuk është përpjekur për të kuptuar apo për ti adresuar shqetësimet legjitime të komunitetit serb në Kosovë, kur është fjala për zbatimin e Marrëveshjeve dhe veçanërisht krijimin e KKS-së. A është kjo qasje e qëndrueshme në afat të gjatë? A është Marrëveshja një sukses në qoftë se ajo e lë komunitetin serb të pakënaqur dhe me heqje të të drejtave nëse KKS-ja nuk ka kompetenca për t'iu përgjigjur nevojave të saj? Si duhet ti drejtohen të gjitha palët kësaj çështjeje?

Ky raport, i realizuar nga OJQ Aktiv, përpiket t'iu përgjigjet këtyre pyetjeve, duke i ofruar analiza interpretimeve të ndryshme të shprehura në Beograd dhe në Prishtinë, kur është fjala për KKS/AKS-së, në kontrast me pikëpamjet e komunitetit lokal në veri të Kosovës. Duke u mbështetur në burimet primare dhe sekondare, duke përfshirë edhe rishikimin e disa analizave dhe dokumenteve politike dhe ligjore, ky raport ofron një pasqyrë të frikës, perceptimeve dhe pritjet të cilat i ka komuniteti serb për themelimin e KKS/AKS-së. Gjetjet kryesore të raportit tregojnë se njohja dhe adresimi i frikave dhe shqetësimet e komunitetit serb, kur është fjala për KKS/AKS-në janë kritike për suksesin e Marrëveshjes së Brukselit dhe integrimin e komunitetit serb në sistemin ligjor të Kosovës. Një KKS/AKS e modeluar sipas nevojave të komunitetit dhe pritjeve të tyre do të rrisë ndjenjën e sigurisë dhe mundësoj punën themelore për marrëdhënie më të qëndrueshme ndërmjet komuniteteve.

Gjetjet:

- Beogradi dhe Prishtina thellësisht kanë interpretime dhe pritje kontradiktore për themelimin dhe rolin e KKS/AKS-së.

"Paqartësia konstruktive" e zbatuar gjatë negociatave ka qenë vendimtare për arritjen e marrëveshjes, por tani ajo punon si një pengesë për të arritur miratimin e saj. Mungesa e qartësisë lejon që të dy qeveritë të shpjegojnë marrëveshjen për publikun e tyre në mënyrë të pjesshme, por edhe brenda dy qeverive ka qëndrimet të ndryshme. Kjo edhe më tej shtyn krijimin e KKS/AKS-së, dhe shton ankthin e komunitetit lokal gjatë gjithë procesit.

- Procesi i themelimit të KKS/AKS-së është teknokratik dhe i mungon fytyra njerëzore. Mungesa e transparencës lëndon procesin si dhe rrit ndjenjën e pasigurisë tek komunitetit serb.

Shqetësimi kryesor është përjashtimi i komunitetit lokal serb nga procesi. Procesi në vete është teknokratike, i varur nga ekspert në grupet punuese dhe negociatave me dyer të mbyllura, të cilit plotësisht i mungon dimension njerëzor. Për qytetarët nuk është e qartë se kush e zotëron këtë marrëveshje dhe cilët janë përfituesit e saj. Elita politike dhe ekspertët e grupit të punës nuk mund të jenë përfituesit kryesorë, por vetëm qytetar në emër të të cilëve u nënshkrua marrëveshja.

- Mungesa e përgjithshme e informacionit në lidhje me procesin, dhe fakti që për më shumë se dy vite ende janë duke e mbajtur formimin e KKS/AKS-së në akull të hollë, ka shkaktuar frikë, pasiguri, pakënaqësi dhe mosbesim në mesin e komunitetit serb gjë që kërcënon të dëmtojë tërë procesin. Durimit të komunitetit serb është duke i ardhur fundi.

Pasiguria dhe pakënaqësia janë emocionet e përhapura në mesin e komunitetit serb në veri. Shqetësimi mbizotërues i komunitetit serb në veri është çështja e marrëdhënieve të ardhshme me Beogradin dhe financimi i KKS/AKS-së. Integrimi i plotë pa masa mbrojtëse në ruajtjen e nivelit të shërbimeve publike të punësimit, shëndetësia dhe arsimit, rrjetet e sigurisë sociale dhe subvencionet nga Beogradi mund të çojnë drejt përkeqësimit serioz të mirëqenies ekonomike të komunitetit dhe si pasojë mund të bëhet problem i madh i sigurisë. Shëndetësia dhe sistemi arsimor janë një pjesë tjetër e rëndësishme e ekuacionit për zbatimin e suksesshëm të Marrëveshjes së Brukselit dhe funksionimin e ardhshëm të KKS/AKS-së. Për qytetarët funksionimi i shëndetësisë dhe arsimit sipas sistemit serb është një vijë e kuqe e cila nuk duhet të kalojë.

- Perceptimet dhe pritjet e komunitetit serb mbi themelimin e KKS/AKS-së janë prozaike, por shqyrtim i kujdesshëm i kërkesave të tyre dhe përmbushja e disa nga pritjeve të tyre një afat të gjatë mund të çojë në integrimin të suksesshëm dhe uljen e tensioneve ndëretnike.

Përkundër faktit se i tërë procesi ka tensione të rënda dhe frikë, krijimi i ardhshëm i Bashkësive të komunave me shumicë serbe, është vlerësuar nga qytetarët si ana më pozitive e marrëveshjes, pasi që ata kanë pritje të mëdha nga themelimi i saj. Kur është fjala për kompetencat e KKS/AKS-së, komuniteti lokal ka më shumë shpresa prozaike, çka do të lehtësojë tensionet ekzistuese në veri dhe do të ofroj siguri për jetesën e tyre në të ardhmen. Para së gjithash, serbët e Kosovës theksuan nevojën për të pasur një trup të pajisur me kompetenca ekzekutive në fusha të veçanta të rëndësishme si në atë të arsimit, shëndetësisë, zhvillimit ekonomik dhe planifikimit urban dhe rural, siç përcaktohet në marrëveshje. Sipas mendimit të tyre, vetëm një organ autonom mund të përmirësojë kushtet e tyre të jetesës dhe mbrojtjen e tyre nga majorizimi në Kosovë dhe të siguroj qëndrueshmërinë e komunitetit.

Rekomandimet:

Me Marrëveshjen e Brukselit, Beogradi, Prishtina dhe komuniteti ndërkombëtar kanë filluar procesin e përfshirjes së komunitetit serb në kornizën ligjore dhe politike të Kosovës. Komuniteti/Asociacioni i komunave me shumicë serbe do të mund të luajë një rol të dobishëm në këtë përpjekje e cila do të mund të përdoret për të qetësuar procesin, të shërbejnë si masë për ndërtimin e besimit me qëllim të rritjes së ndjenjës së sigurisë dhe besimit të komunitetit me vendosjen e themeleve për krijimin e marrëdhënieve më të qëndrueshme ndër-komunitete. Me qëllim lehtësimi ofrojmë:

Rekomandime të përgjithshme mbi Komunitetin/Asociacionin e komunave me shumicë serbe:

- Kompetenca më të mëdha duhet të barten tek Komuniteti/Asociacioni i komunave me shumicë serbe, duke përfshirë fuqitë ekzekutive në arsim, shëndetësi, zhvillimin ekonomik dhe planifikimin urban dhe rural. Kjo nuk duhet të perceptohet si një kërcënim për komunitetin shqiptar të Kosovës, por si një model i jetës së përbashkët në Kosovë; një faktor që do të sigurojë stabilitet afatgjatë duke ofruar risigurime fillestare të komunitetit serb për sigurinë e tyre dhe një premtim për të ardhmen e përbashkët të begatë për të dy komunitetet në këtë pjesë të Ballkanit. Rritja e kompetencave të parashikuara në ligjet aktuale të Kosovës, nuk do të jetë me koncesion të paparë, por një shenjë e qeverisjes demokratike dhe tregues i pjekurisë së shoqërisë së Kosovës. Për të ndërtuar besimin është e domosdoshme që shumica dominuese të ketë konsideratë ndaj pakënaqësive dhe shqetësimeve të pakicave etnike. Për të arritur këtë objektiv, ndryshimet në ligjet e caktuara të Kosovës, pra (Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligji për bashkëpunimin ndërkomunal; Ligji për Vetëqeverisjen Lokale dhe Financat) mund të shihet si një shenjë e vullnetit të mirë dhe një shenjë e dëshirës së sinqertë për integrimin e qëndrueshëm të serbëve të Kosovës në shoqëri.
- Lidhjet origjinale në mes të serbëve të Kosovës dhe Beogradit duhet të njihen si interes legjitim. Në këtë frymë, interpretimi i kornizës ligjore të Kosovës dhe marrëveshjet e arritura në dialogun e Brukselit, veçanërisht në KKS/AKS duhet të jenë pozitive në drejtim të një qëllimit të tillë. Së bashku me rrjetin e dendur të mbrojtjes ligjore nëpërmjet politikës së decentralizimit dhe interpretimin konstruktiv të Marrëveshjes së Brukselit, të mbështetur nga Beogradi mund të ndihmojë në lehtësimin e mosbesim dhe shqetësimeve të komunitetit serb në Kosovë. Qasja konstruktive nga Beogradi, i cili vazhdimisht konsultohet me elitën politike në Prishtinë në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të komunitetit serb të Kosovës dhe mban linjat e komunikimit të hapur me qëllim të adresimit të

çështjeve në lidhje me këtë mund të shihet më tepër si pasuri sesa si një problem.

- Financimi i punësimit publik, projektet infrastrukturore dhe projektet që synojnë në drejtim të zhvillimit ekonomik në zonat me shumicë serbe deri tani kanë qenë thelbësore për mbajtjen e paqes sociale, sigurisë dhe parandalimin e emigrimit të serbëve. Nëse i çasemi nga këndvështrimi i zhvillimit ekonomik, përkrahja financiare e komunitetit serb nga Beogradi do të mund të shihet si gjë pozitive pasi që ajo do të mund të mbajë nivelet e punësimit dhe të prokurimit publik në Kosovë, pra duke kontribuar për ekonominë e tërë Kosovës. Megjithatë, siç është propozuar nga Grupi i Hulumtimeve të Politikave në Ballkani, Beogradi duhet të kryejë një auditim të plotë të shpenzimeve dhe punësimeve publike aktuale përmes institucioneve serbe në Kosovë, pas kësaj masë duhet të propozojë linjat e pranueshme të kanalizimit e financave përmes institucioneve të Prishtinës.
- KKS/AKS duhet të kenë kompetenca ekzekutive në katër fusha të listuara sipas marrëveshjes, por edhe të koordinojë veprimin në të gjitha fushat e tjera të rëndësishme për komunitetin serb të Kosovës, siç janë: shërbimet publike, minierave, kompanive publike, pronësisë dhe menaxhimit të pronës etj.
- KKS/AKS do të duhej të jetë organizëm politik, përfaqësues i komunitetit serb të Kosovës. Struktura, sistemi i vendim-marrjes dhe modeli i përfaqësimit të KKS/AKS-së duhet të garantojë "të drejta të barabarta" të të dy komuniteteve gjeografikisht të ndara të serbëve të Kosovës, jo vetëm nga komunat serbe me shumicë, por edhe ata përfaqësues serbë të shpërndar rreth e rrotull nëpër enklava në mënyrë që të shërbejë si organ përfaqësues i vërtetë i serbëve të Kosovës. Për arsye të njëjta, krijimi i KKS/AKS-së duhet të parashikojë mekanizma për parandalimin e kontrollit/dominimit të bazuar në stilin partizan.
- KKS/AKS duhet ta qeveris Fondin e Zhvillimit për veriun dhe ta përdor atë për zhvillim të barabartë të të gjitha komuniteteve serbe në Kosovë, duke përfshirë edhe ato në jug të lumit Ibër. Si shtesë KKS/AKS duhet të menaxhoj në mënyrë transparente dhe të qëllimshme kërkesat dhe fondet e ndara nga buxheti i Republikës së Serbisë.
- KKS/AKS duhet të luajë një rol udhëheqës në administrimin e arsimit dhe shëndetësi së Serbisë për komunitetin serb në Kosovë, veçanërisht në lidhje me institucionet e interesit të komunitetit të gjerë, siç është Universiteti i Mitrovicës së Veriut dhe qendrat e mesme mjekësore. Komunat nuk kanë burime apo

përvojë të mjaftueshme për të drejtuar sisteme të tilla të komplikuara si arsimit Universitar dhe kujdesi shëndetësor sekondar. Shërbimi shëndetësor dhe arsimit serb në Kosovë janë sistemet masive të drejtuara dhe të financuara përmes ministrive të linjës në Beograd të cilat sigurojnë qëndrueshmërinë e tyre. Në mënyrë që të sigurohet cilësia maksimale e shërbimit departamentet e KKS/AKS-së për shëndetësi dhe arsim duhet të paisen me njohuri nga ministritë e linjës serbe në mënyrë që të bashkëpunojnë ngushtë në çështjet kryesore. Financimi për arsim dhe shëndetësi duhet të kryhet përmes KKS/AKS-së në vend të komunave.

- Sipas propozimit të raportit të BPRG, Asociacioni/Komunmiti duhet të ofroj pro bono ndihmë ligjore dhe ndihmë tjetër në mënyrën e çasjes me institucionet qendrore, veçanërisht për serbët e izoluar në enklava.

Për Beogradin, Prishtinën dhe BE-në:

- Mungesa e përgjithshme e informacionit në lidhje me procesin, dhe fakti që për më shumë se dy vite ende janë duke e mbajtur formimin e KKS/AKS-së në akull të hollë ka shkaktuar frikë, pasiguri, pakënaqësi dhe mosbesim në mesin e komunitetit serb në veri. Të tria palët duhet të zotohen që të rrisin transparencën e procesit duke botuar propozimet fillestare të Statuteve të KKS/AKS-së për shqyrtim publik. BE-ja gjithashtu duhet të bëjë presion tek të dyja palët, ashtu që pas negociatave për KKS/AKS në Bruksel, të bëjnë **deklarata të përbashkëta** në lidhje me marrëveshjet e mundshme të arritura, pasi që kjo do të zvogëlonte mundësinë për interpretime
- Negociatat trepalëshe për krijimin e KKS/AKS duhet të fillojnë sa më shpejt që të jetë e mundur, mundësisht në mes të takimit të ardhshëm mes dy kryeministrave të planifikuar për 23 qershor në Bruksel. Jo vetëm për shkak të kushtëzimit të BE-së në procesin e integritetit në BE, por për shkak se KKS/AKS-ja duhet të zgjidhë një numër të çështjeve shqetësuese dhe lehtësimin e pasigurve të krijuara nga Marrëveshja e Brukselit. Ky vazhdim i status quo-së nuk është i qëndrueshëm në afat të gjatë dhe për këtë arsye një zgjidhje për vendosjen e KKS/AKS-së është e domosdoshme.
- Krijimi i KKS/AKS-së nuk mund të jetë subjekt i mbylljes së "të ashtuquajturave" institucione paralele, këto dy procese duhet të shkojnë dorë për dorë. Shkatërimi i parakohshëm i këtyre institucioneve do të bëjë komunitetin serb të ndjehet pa të drejta si dhe, edhe më negativ në drejtim të procesit. Para mbylljes së tyre, një zgjidhje duhet të gjendet për të gjithë ata punonjës të cilët mund të bëhen të

tepërt për shkak të integritimit, apo nëpërmjet punësimit përmes KKS/AKS-së, ose përmes ndonjë lloj pensionimi të garantuar, si në rastin e mbrojtjes civile dhe policisë. Megjithatë, rrjetet e caktuara të sigurisë sociale të ofruara përmes ministrive të linjës së Beogradit duhet të vazhdojnë të funksionojnë përmes KKS/AKS-së dhe të financohen në mënyrë transparente nga Beogradi.

Për Prishtinën dhe Beogradin

- Procesi politik në Bruksel nuk është një lojë me rezultat zero, kështu që elita politike në Beograd dhe Prishtinë duhet ndaluar diskutimin e tyre në drejtim të fitimit apo humbjes, por më tepër të fillojë të krijojnë një imazh më pozitiv për procesin. Të dy qeveritë, përfaqësuesit politikë dhe zyrtarë të tjerë në Kosovë dhe Serbi duhet të pushojë diskursin e të ushqyerit të armiqësisë që nxit nacionalizmin dhe krimet e motivuara etnikisht në kthesën kryesore drejt bashkëpunimit për projekte rajonale të përbashkëta zhvillimore për të krijuar jetesë më të sigurt për ata që i përfaqësojnë.
- Beogradi dhe Prishtina duhet të ken kujdes me financimin e ardhshëm të komunitetit serb në Kosovë, duke marrë parasysh qëndrueshmërinë dhe varësinë e saj ndaj punësimit në sektorin publik, si dhe pasojat e një rezolute të parakohshme të cilën mund ta shkaktoj kjo çështjeje.

Për qeverinë në Prishtinë:

- Prishtina do të duhej të ndryshojë ligjet ekzistuese në mënyrë që të mundësojë akomodimin e themelimit të Komunitetit/Asociacionit të Komunave me shumicë serbe. Duhet të miratohet ligji Omnibus për Komunitetin/Asociacionin, që përfshin jo vetëm kompetencat e saj, por edhe nivelin e financimit lidhur me Qeverinë në Beograd dhe Prishtinë.
- Siç është shpjeguar në rekomandimet e përgjithshme, financimi nga Beogradi për qëllimet e mirëqenies dhe zhvillimit të komunitetit serb nuk duhet të përceptohet si një kërcënim për derisa ai është duke u kryer me anë të thesarit në Prishtinë dhe për qëllime të qarta.
- Siç është propozuar nga raporti Big Deal, qeveria në Prishtinë duhet inkurajuar që të hartoj dhe zbatoj një strategji të re në terren për komunitat veriore. Kjo do t'i shtonte besim deklaratave për mbështetje dhe përfshirje të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Nga një lojë me rezultat zero dhe një lojë me diskurs të një integritimi me forcë do të duhej të ndryshohej drejt diskursit të bashkëpunimit.

Për qeverinë në Beograd:

- Hapja e konsultimeve për projekt-statutin, për një rreth më të gjerë të komunitetit serb, dmth. udhëheqësinë politike, shoqërinë civile, universitetin. Ku ata do të mund të ofrojnë këshilla të vlefshme në atë se çka është e mundshme për zbatimin e procesit
- Ti jap më shumë liri në shprehje dhe përgjegjësi udhëheqjes lokale politike serbe dhe ti mbështes ata që të jenë më proaktiv në këtë proces.
- Të garantoj burimet financiare për funksionimin e ardhshëm të KKS/AKS-së së komunitetit serb në Kosovë dhe të dëshmoj qartë se qëllimi i Beogradit zyrtar është që të vazhdojë të financojë zhvillimin ekonomik dhe funksionimin e institucioneve në komunat me shumicë serbe. Është e rëndësishme që flukset financiare nga Serbia të bëhen më transparente, në mënyrë që të ofrohet mbështetja e duhur për zhvillimin ekonomik të rajonit, si dhe për të zvogëluar shqetësimet e tendencave centrifugale Prishtinës.

Për udhëheqësin politike serbe:

- Udhëheqësia politike serbe në Kosovë duhet të kërkojnë një rol më të madh në procesin e negociatave për krijimin e organizatave të shoqërisë civile. Një sinjal pozitiv ishte se ata morën pjesë në raundin e parë të takimit të mbajtur në Bruksel. Nëse ata dhënë legjitimitet për të gjithë procesin e Marrëveshjes së Brukselit përmes pjesëmarrjes në zgjedhjet lokale dhe qendrore, ata duhet të përdorin privilegjet dhe kompetencat e deleguara nga ligji për të bërë presion në udhëheqjen politike në Prishtinë për të respektuar marrëveshjet e nënshkruara mbi themelimin e KKS/AKS-së.
- Përdorimin e potencialit të sektorit të shoqërisë civile serbe në Kosovë dhe të konsultohet me ta në çështjen e themelimit të KKS/AKS –së.
- Të ftohen palët e interesuara të komunitetit serb për konsultime rreth themelimit të KKS/AKS-së.

Parathënie –të gjitha shqetësimet ne nje vend

Kjo nuk ka asgjë të bëjë me Komunitetin/Asociacionin e komunave me shumicë serbe! Tani bëhet fjalë për frikën! Serbët e Kosovës druajnë nga diskriminimi dhe magjorizimi, Shqiptarët e Kosovës dhe komuniteti ndërkombëtar druajnë nga një Republikë e re serbe, sistem jo funksional dhe tendenca centrifugale, kurse politikanët druajnë nga përceptimi se janë të dobët dhe nga frika mos po bëjnë gabim”

Ky citim i qëllimshëm është marrë nga filmi "Shuma e të gjitha Frikëve" (2002), bazuar në romanin e Tom Clancy-t, me qëllim të parashikimit metaforik të gjendjes së punëve, kur është fjala për krijimin e Komunitetit / Asociacionit të komunave me shumicë serbe (KKS / AKS) ¹. KKS ka qenë themeli i procesit të marrëveshjes së Brukselit, i prezantuar si një kornizë për integrimin e qetë të komunitetit serb në sistemin juridik dhe politik të Kosovës. Dy vite pas nënshkrimit të marrëveshjes, krijimi i KKS-së, së pari i paraparë për fundin e vitit 2013, ende valvitet në ajër dhe është subjekt i mosmarrëveshjeve të shumta, argumenteve të ashpra, keqinterpretimeve dhe vonesave që vijnë nga të gjitha anët.

Të gjithë akterët janë kapur në një cikël të përjetimit të shqetësimeve, të cilat më tej përkeqësojnë tensionet mes komuniteteve në nivel të vendit, duke çuar në vonesa të zgjidhjes së çështjes dhe krijimin e KKS-së.

Arsyeja kryesore për vonesë është mungesa e qartësisë dhe kuptimit të rolit dhe pushtetit të këtij organi. Formulimet e paqarta të përdorura në marrëveshjen e Brukselit ishin të dobishme për të gjetur një pikë të konvergjencës në kohën kur është arritur marrëveshja, por tani e njëjta paqartësi është një pengesë për zbatimin e saj, sepse të dyja palët kanë tendencë për të interpretuar përmbajtjen e saj në bazë të interesave të tyre kontradiktore. Draft statuti, i cili është dashur të zhvillohet nga Ekipi i Menaxhimit të katër komunave veriore serbe edhe pse disa muaj pas nënshkrimit të ashtuquajturës marrëveshje në Bruksel në 19 prill 2013, ende nuk është në dispozicion për publikun duke mbetur si subjekt i spekulimeve.

Situata politike rreth krijimit të KKS-së ishte gjithashtu tepër e ndërlikuar: periudha zgjedhore në Serbi, në BE dhe në Kosovë në vitin 2014 dhe gjashtë muaj bllokim të formimit të një qeverie në Prishtinë kanë vonuar procesin e implementimit dhe kanë lënë komunitetin serb në Kosovë, në një gjendje të papërcaktuar. Pavarësisht marrëveshjes së koalicionit të arritur ndërmjet Srpska Lista, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dhe të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), e cila parashihte krijimin e KKS-së nga mesi i muajit maj të vitit 2015, kundërshtime konstante brenda koalicionit, problemet e brendshme në Kosovë dhe mungesa e listës Serbe nga qeveria

¹Shkurtesat KKS dhe AKS përdoren në mënyre simultante përbrenda dokumentit; KKS përdoret me rastin e shpjegimeve të pozicionit të Beogradit dhe komunitetit lokal, përderisa AKS përdoret kur shpjegohet pozicioni i Prishtinës

për dy muaj, duke pas para syshë heqjen e Ministrit për Komunitete dhe Kthim, udhëheqësin e listës Srpska, Aleksandar Jablanović-it nga zyra, edhe më tej kanë ndikuar negativisht në krijimin e KKS-së.

Duket se, më në fund, pas vonesave të shumta dhe vizitave të akterëve ndërkombëtarë, palët do të të mblidhen së shpejt në Bruksel për të diskutuar çështjen e KKS-së, kompetencat e saj dhe rrugën drejt themelimit të saj. Diskutimet e para të njohura për publikun janë mbajtur në fund të muajit maj në ambientet e Shërbimit European të Veprimit të Jashtëm (SHEVJ) midis zyrtarëve të BE-së dhe Beogradit të shoqëruar me nga dy përfaqësues të komunitetit serb të Kosovës. Përfaqësuesit nga Prishtina munguan në takim.

Vonesat në themelimin e KKS-së ndikuan negativisht tek serbët e Kosovës. Nën presion të mungesës së mundësive ekonomike, mungesa e mundësive për zhvillimin social, kushtet e dobëta të sigurisë, si dhe në raport me institucionet përfaqësuese duke mos qenë në gjendje për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive nevojave të tyre, shpresa të mëdha i janë mveshur KKS-në për të zgjidhur një numër të shqetësimeve të tyre si dhe shkarkimi nga pasiguria e krijuar nga Marrëveshja e Brukselit.

Ky raport ka për qëllim të ofrojë një analizë të interpretimeve të ndryshme të shprehura në Beograd dhe në Prishtinë kur bëhet fjalë për KKS-në, të kundërshtuar me pikëpamjet e komunitetit lokal në Kosovën veriore. Ky dokument ka për qëllim tu ofrojë rekomandime vendimmarrësve që do të përmirësonin kushtet jetësore të serbëve të Kosovës duke i marrë parasysh qëndrimet e tyre. Është e panevojshme të thuhet se një ngritje e mundësive ekonomike

dhe zhvillimeve kulture për komunitetin serb është në interes të Kosovës dhe rajonit në tërësi, sepse një avancim i tillë mund të zvogëlojë tensionet dhe mund të lehtësojë zhvillimin e marrëdhënieve paqësore mes grupeve etnike.

Hulumtimi, së pari është bazuar në të dhënat e marra nga intervistat të kryera nga anëtarët e stafit të AKTIV-it të zhvilluara me udhëheqësit e komunitetit dhe ekspertët nga Beogradi, Prishtina dhe Kosova veriore. Gjithashtu, në mënyrë që të fitohen njohuri për pikëpamjet dhe shqetësimet e qytetarëve lidhur me Marrëveshjen e Brukselit, intervista u shoqërua nga 6 grupe të fokusit të zhvilluara në veri të Kosovës, brenda 5 muajve të fundit. Hulumtimi gjithashtu përfshinë edhe shqyrtimin e disa dokumenteve politike dhe ligjore duke përfshirë edhe raportet zyrtare të cilat kanë qenë thelbësore për të kuptuar situatën në thellësi. Qëllimi ynë ka qenë për të mirren informacione nga këndvështrime të ndryshme me qëllim të përshkrimit të mënyrës më të qartë të të gjitha opsioneve politike si dhe sigurimit të analizave të paanshme dhe rekomandimeve bazuar në nevojat e qytetarëve. Në veçanti, burimet e përdorura në këtë raport janë raportet zyrtare nga institucionet qeveritare të Beogradit dhe Prishtinës, OJQ-të, si dhe organizatave të BE-së dhe atyre ndërkombëtare përfshirë edhe raportet e mediave serbe dhe të Kosovës.

Marrëveshja e Brukselit

"Marrëveshja e parë për parimet që qeverisin normalizimin e marrëdhënieve" i.e. -Marrëveshja e Brukselit është parë si një "ndryshues loje" në procesin e normalizimit të marrëdhënieve mes Beogradit dhe Prishtinës. Pas dy viteve të diskutimeve teknike, të cilat kanë hapur një shteg për negociatat në nivel më të lartë midis dy kryeministrave dhe tetë raundeve të diskutimeve, marrëveshja u nënshkrua në Bruksel më 19 Prill 2013. Për Beogradin, hapja e negociatave për anëtarësim ishin në rrezik, dhe rruga drejt saj ishte përparimi në normalizimin e procesit të dialogut. Për Prishtinën, përveç procesit të Procesit të Stabilizim Asociimit (PSA), përfitimi kryesor ishte zgjerimi i juridiksionit të tij ligjor në katër komunat veriore. Rezultatet e marrëveshjeve të normalizimit kanë qenë të përziera më së miri, pavarësisht nga fakti se vetëm katër (4) prej gjashtëmbëdhjetë (16) marrëveshjeve, që nga viti 2011 janë zbatuar plotësisht, shtrirja e zbatimit të 12 marrëveshjeve të mbetura ndryshon.² Veçanërisht shqetësuese janë vonesat në zbatimin e marrëveshjes së prillit. Duke qenë si një "gur i çmuar në kurorë" nga të gjitha marrëveshjet dhe e përshkruar si historike, si dhe një nga sukseset më të mëdha të diplomacisë evropiane³, dy vite më vonë ajo nuk arriti të prodhojë rezultate të qarta. Krijimi i Komunitetit të Komunave Serbe (KKS), i cili është subjekt i gjashtë pikave të para të

marrëveshjes, ka dëshmuar të jetë një bllok kryesor pengues për zbatimin e tij dhe si strehim i njëpasnjëshëm i komunitetit serb në kornizën ligjore të Kosovës. Ndjeshmëria e KKS-së për të dyja palët Beogradin dhe Prishtinën po reflektohet në mënyrën se si është interpretuar dhe prezantuar tek publiku përkatës, duke krijuar mosmarrëveshje të mëtutjeshme dhe pasiguri.

Një marrëveshje e muajit prill propozon krijimin e një organi autonom të integruar në sistemin e Kosovës. Në mënyrë të veçantë, marrëveshja thekson se "do të jetë një Asociacioni/ Komunitet i komunave me shumicë serbe", me të anëtarësim të hapur për "çdo komunë tjetër".⁴ Strukturat e KKS-së "do të vendosen në të njëjtën mënyrë si të statutit ekzistues të Asociacionit të Komunave të Kosovës", kështu që me mbështetjen e kryetarit, zëvendës-kryetarit, Kuvendit dhe Këshillit.⁵ Përbërja e strukturave të KKS-së varet nga zgjedhjet komunale të cilat janë rezultat i zgjedhjeve lokale dhe do/duhet të thithin individët e besuar me mandate në nivel lokal/komunal.

Në nenin 4 dhe 5 të marrëveshjes është përcaktuar se KKS do të ketë "pasqyrë të plotë" në fushat e mëposhtme:

² BIRN (2015) – „Punë e madhe – Të humbur në stagnim“, shih: http://crta.rs/uploads/documents/2015-04-27%2010:05:10_a_44_1_en_doc.pdf „Nga 16 marrëveshje, vetëm katër kanë qenë të zbatuara në tërësi. Vulat e doganave, shkëmbimi i regjistrave civil, zgjedhjet komunale në Kosovën veriore dhe themelimi i komitetit për zbatim. Ky nuk është një ndryshim nga gjatë muajt e kaluar.“

³ EU Observer (2013) “Kosovë-Serbi vlerat e dukshme të marrëveshjeve të shërbimeve diplomatike të BE-së”, Shih: <https://euobserver.com/opinion/119903>

⁴ Marrëveshja e parë e parimeve të qeverisjes së marrëdhënieve të normalizuara, neni 1

⁵ Ibidem, Neni 3

- Zhvillimin ekonomik;
- Edukim;
- Shëndetësi;
- Planifikimin urban dhe rural;
- Kompetencat të mundshme shtesë të deleguara nga autoritetet qendrore.⁶

Sipas nenit 6 të marrëveshjes, KKS "do të ketë rol përfaqësues në autoritetet qendrore dhe do të kenë një vend në Këshillin Konsultativ për Komunitete, për këtë qëllim".⁷

Ideja prapa Marrëveshjes së Brukselit dhe krijimi i KKS-së është për të lehtësuar integrimin e veriut të Kosovës në sistemin juridik të Kosovës dhe t'i japë fund viteve të ekzistimit të dy sistemeve paralele të cilat kanë funksionuar në mënyrë të pavarur, në mes të komunave të veriut dhe Prishtinës. Rezistenca e komunitetit serb nga veriu që të integrohen në sistemin ligjor të Kosovës ka qenë në temë përplasje me aspiratat evropiane të qeverisë në Beograd. Nën presionin e BE-së, Serbia pranoi të heqë dorë nga kontrolli administrativ mbi këtë rajon dhe të braktisin idetë e ndarjes, por mori mundësinë për të ushtruar ndikimin përmes KKS-së.⁸ Subjekti i ri do të mund të jetë organi përfaqësues i serbëve të Kosovës të vendosur për të mundësuar kontrollin më efikas dhe efektiv mbi kompetencat e transferuara për komunat, si dhe të sigurojë mbrojtje më të mirë të të drejtave të komuniteteve.

Për fat të keq për shkak të paqartësisë së Marrëveshjes së Brukselit nuk ofrohen informata specifike mbi mënyrën se si do të funksionojë ky organizëm i ri institucional. "Pasqyra e plotë" e Marrëveshjes nuk e sqaron natyrën e as shkallën e fuqisë së besuar tek KKS-ja duke lënë hapësirë për interpretime tëndryshme nga të dy palët. Raporti i shkruar nga Qendra për Qeverisje Gjithpërfshirëse (QQGj), thekson nivelin e mosmarrëveshjeve dhe pasigurisë midis serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës mbi interpretimin se çfarë nëkupton termi "pasqyrë e plotë". Fjala "overview" (pasqyrë) është më e paqartë. Fraza "Asociacioni do të ketë pasqyrë të plotë mbi" nuk është mjaft e qartë, madje edhe në gjuhën angleze. Dikush do mund të "jap" apo "ofroj" një pasqyrë, por jo "të ketë pasqyrë". E njëjta gjë vlen edhe për përkthim në gjuhën shqipe të termit "overview", "vështrim". Nuk mund të "keshë vështrim," mund të ofrojë vështrim. Përkthimi në gjuhën serbe "nadležnost" (kompetenca) është më e afërt me

⁶ Ibidem, Neni 4, 5

⁷ Pikat tjera të marrëveshjes (Nenet 7, 8, 9, 10) janë të are dedikuara për integrimin e strukturave serbe të sigurisë në Policinë e Kosovës, integrimi i sistemit juridik dhe përkushtimi që asnjëra palë nuk do të bllokonë procesin e integritit në BE

⁸ Malazogu, L., Ejdu, F., Niç, M. dhe Žornaczuk, T. (2014) "Integrimi apo Izolimi: Kosova veriore në ngërçin elektorale 2014", CEPI.

interpretimin serb të mandatit të Asociacionit, por nuk është një përkthim i saktë i fjalës "overview" - "pasqyrë". "Pregled" është një përkthim më i saktë"⁹

Përsa i përket strukturës, Marrëveshja i referohet kryetarit, zëvendëskryetarit, kuvendit dhe këshillit siç është përcaktuar në kuadër të statutit ekzistues të Asociacionit të Komunave të Kosovës, por kjo nuk përmend se si do të emërohen anëtarët e këtyre zyrave, veçanërisht nëse ata duhet të zgjidhen nga kuvendet e komunave ekzistuese apo të zgjidhen me ndonjë proces tjetër. Gjithashtu paqartësi ka edhe në emrin e trupit, për shkak se Asociacioni dhe Komuniteti nuk janë e njëjta gjë dhe se përdorimi i njërës në vend të tjetrës është bërë një çështje tjetër politike: Beogradi preferon termin Komunitet (srb. Zajednica; sh. Komuniteti), i cili tregon një entitet të ri dhe më të fortë, ndërsa Prishtina insiston në termin Asociacion (srb. asocijacija; shq.shoqatë), i cili është në përputhje me kornizën ekzistuese ligjore, dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës.

Aktualisht, shumë pak ka njohuri publike në lidhje me hartën e re rrugore të krijimit të KKS-së, kompetencat, bazat ligjore dhe marrëdhëniet me Beogradin. Sipas planit të zbatimit, një ekip i menaxhimit ka qenë i përbërë nga përfaqësuesit e katër komunave veriore, në mënyrë të krijimit të një draft statutit.¹⁰ Në janar të vitit 2014 u njoftua se ekipi ishte në finalizim të dokumentit dhe se së shpejti do të publikoheshin disa informata. Edhe pse përshkruar si një produkt i pronësisë vendore, statuti në realitet ishte hartuar nga ekipi teknik i deleguar nga qeveria në Beograd, në mënyrë që të mos pengojë progresin në dialogun e Brukselit. Për komunitetin lokal në veri draft statuti ka pothuajse një natyrë mistike dhe është mbështjellë me një vello të fshehtësisë. Deri më sot, edhe pse u premtua, draft statuti nuk është shpallur për publikun. Sipas burimeve të pazbuluara nga qeveria, një projekt statut është dërguar në Bruksel, por ai është hedhur poshtë si tepër optimist dhe është kthyer për rishikim. Për Prishtinën, statuti ekzistues i Asociacionit ekzistues të komunave të Kosovës është afër fundit, dhe se asnjë statut që i beson më shumë kompetenca se sa ato të përcaktuara me ligjet ekzistuese të Kosovës nuk është i pranueshëm.

Procesi gjithashtu është penguar nga zgjedhjet e mbajtura në Serbi në vitin 2014 (mars), BE në (maj) dhe në Kosovë në (qershor) dhe nga ndalesa e cila ndodhi gjatë procesit të krijimit të qeverisë së re në Prishtinë. Marrëveshja e koalicionit arritur në mes të PDK-së, LDK-së dhe Listës Srpska kishin një pikë të qartë se KKS do të jetë një prioritet për kabinetin e ri dhe se do të jetë i vendosur në mes të marsit dhe majit 2015. Shkarkimin e Ministrit për Komunitete dhe Kthim, Jablanovic, udhëheqësit të Listës Srpska, nga qeveria, pas presionit nga partitë opozitare dhe publiku në Prishtinë ka pasur pasoja të rënda për procesin dhe i ka përkeqësuar tensionet në mes të dy palëve. Lista Srpska u largua nga qeveria dhe e ka kushtëzuar kthimin e saj me krijimin e KKS-

⁹ CIG (2015) „Implementimi i Marrëveshjes së Brukselit dhe Perspektiva Evropiane e integrimit të Kosovës dhe Serbisv“, Shih:

<http://www.cigonline.net/docs/Implementation%20of%20Brussels%20Agreement%20and%20European%20Integration%20Prospects%20for%20Kosovo%20and%20Serbia.pdf>

¹⁰ Morina, E. (2014) “Bruksael “ Marrëveshja e parë” – Një vit pas”, Konrad Adenauer Stiftung

së, por në fund vendosën për shumë më pak, kur deputetët e Serpskës dhe qeveritarë u kthyen në institucione në fund të prillit.

Afati i përcaktuar nga marrëveshja e koalicionit ka skaduar më 12 maj dhe nuk janë majtur diskutime mbi KKS-në në kuadër të institucioneve qendrore. Në qoftë se diçka kemi mësuar nga proceset e deritanishme duket se komuniteti ndërkombëtar duhet të bëjë presionin mbi të dyja palët në mënyrë që të shohin progres. Pas vizitave të Ministrisë gjermane të Punëve të Jashtme në Beograd dhe Prishtinë në maj, procesi u përshpejtua. Kjo ishte dëshmi se presioni ndërkombëtar dhe ndikimi ishte i nevojshëm për të lëvizur gjërat përpara. Të dyja palët u bindën për të ndërmarrë hapa të vështirë në zbatim. Për Beogradin se ishte e rëndësishme që bisedimet për KKS-në të fillojnë sa më shpejt që të jetë e mundur, por që ajo të ndodhë disa rezultate duhej treguar në zbatimin e marrëveshjeve të mëparshme. Hapat janë marrë nga Beogradi, dhe Zyra e Qeverisë për Kosovë dhe Metohisë për të lehtësuar frikën e komunitetit lokal dhe për të bindur anëtarët e gjyqësorit dhe Mbrojtjes Civile (Civilna zastita) për tu integruar ashtu si është parashikuar nga marrëveshjet e nënshkuara në Bruksel. Prishtina duhet të marrë hapa të vështirë në miratimin e Ligjit mbi Gjykatën Speciale. Pavarësisht nga e gjithë kjo duket se të dyja palët janë shumë larg për një numër çështjesh të rëndësishme dhe kanë interpretime kontradiktore në bisedimet për krijimin e KKS-së. Më në fund diskutimet paraprake në nivel teknik për KKS-në janë mbajtur në Bruksel, në Shërbimin Evropian të Veprimit të Jashtëm (SHEVJ), më 26 maj, por vetëm delegacioni nga Beogradi ishte i pranishëm në takim. Zyrtarët në Prishtinë kanë arsyetuar mungesën e tyre duke pretenduar zbatim të pamjaftueshëm të marrëveshjeve të mëparshme, si dhe çështjet e brendshme politike në lidhje me krijimin e Gjykatës Speciale.¹¹

¹¹ B92 (2015) „Shqipëtarët nuk erdhën në bisedime për AKS– në “. Shih: http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=05&dd=26&nav_category=640&nav_id=996706

Themelimi i KKS-së: Interpretime kontradiktore dhe pritjet

"Paqartësia konstruktive" e zbatuar gjatë negociatave ka qenë vendimtare për arritjen e marrëveshjes, por tani ajo punon si një pengesë për të arritur miratimin e saj.¹² Mungesa e qartësisë lejon që të dy qeveritë të shpjegojnë marrëveshjen për publikun e tyre në mënyrë të pjesshme, por edhe brenda dy qeverive ka qëndrimet të ndryshme. Në njërën anë të spektrit, është një përpjekje që këtij organ institucional ti sigurohen përgjegjësi të mëdha ekzekutive. Nga ana tjetër, disa besojnë se KKS-ja është e krahasueshme me një OJQ me mandat për mbikëqyrje. Të dyja palët gjithashtu kanë interpretime kontradiktore në kohën e themelimit të KKS-së; ndërsa Prishtina pohon se shumica e marrëveshjeve duhet të zbatohen para themelimit të KKS-së, pikëpamja e Beogradit është se KKS-ja duhet të themelohet bashk me zbatimin e marrëveshjeve të tjera. Themelet ligjore gjithashtu janë diskutabile, pasi që njëra palë, pretendon se KKS-ja mund të themelohet sipas ligjit aktual të Kosovës, ndërsa pala tjetër kërkon ndryshime në mënyrë që KKS-ja të vendoset në sistemin juridik. Financimi i KKS-së dhe çështja e punësimit në sektorin publik të ofruar nga Serbia deri më tani do të adresohen, këto çështje kanë dëshmuar të jenë pengues në këtë proces. Një perceptim i përbashkët është se serbët e Kosovës kanë qenë të përjashtuar nga procesi i negociatave që çoi në Marrëveshjen e Brukselit dhe se qytetarët nuk janë të informuar siç duhet në lidhje me atë se çka do të thotë KKS-ja për ta. Në seksionet e mëposhtme të këtij dokumenti, interpretimet kundërtë të Beogradit dhe Prishtinës mbi KKS-në do të paraqiten në detaje, ndjekur nga perceptimet e komunitetit serb nga Kosova e Veriut.

Pozita e Beogradit – Asgjë nuk është rënë në dakord para se çdo gjë t'bihet në dakord

Zyrtarisht, pozita e mbajtur nga Republika e Serbisë mbi Kosovën ka disa pika fikse: Serbia kurrë nuk do të njohë pavarësinë e Kosovës dhe kjo gjithmonë do të mbrojtë të drejtat e popullatës serbe në Kosovë. Në realitet, Beogradi ka vendosur edhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian si qëllim strategjik dhe qeveria duket e hapur për të bërë lëshime në lidhje me çështjen e Kosovës, në mënyrë që të arrijë atë. Në këtë kuptim, Marrëveshja e Brukselit ka qenë një pikë kritike për procesin e integritimit në BE. Kjo u konfirmua nga vendimi i marrë nga Këshilli i Evropës më 28 qershor 2013 për hapjen e negociatave të pranimit me Serbinë dhe fillimin e bisedimeve që pasuan në periudhën janar 2014. Hapja e kapitullit për bisedime rreth pranimit për Serbinë janë gjithashtu subjekt i "zbatimit të plotë" të Marrëveshjes së Brukselit. Të gjitha negociatat e pranimit do të pasqyrohen dhe kushtëzohen nga kapitulli 35 i cili do të ndjekë nga afër procesin e bisedimeve në mes të Beogradit dhe Prishtinës. Shumë besojnë se

¹² Ejodus, F. (2014) "Marrëveshja e Brukselit dhe interesat nacionale të Serbisë: Një faqe bilanci pozitiv", Konrad Adenauer Stiftung.

anëtarësimi i Serbisë në BE do të kushtëzohet me nënshkrimin e marrëveshjes detyruese me Kosovën për normalizimin e marrëdhënieve¹³.

Pozicioni i qeverisë serbe për Kosovën zyrtarisht është shprehur në Platformën e Kosovës, një dokument i brendshëm të miratuar në vitin 2013¹⁴. Platforma, që në mënyrë të qartë refuzon njohjen e pavarësisë së Kosovës, ka kërkuar nivel të lartë të autonomisë për atë është që të bëhet KKS brenda kuadrit institucional të Kosovës dhe Metohisë, dhe në shumë raste kërkon një nivel autonomie e cila i tejkalon kompetencat e municipalities.¹⁵

Marrëveshja e Brukselit definitivisht nuk përputhet me shtrirjen e kompetencave të transferuara të kërkuara në dokumentin për platformën e Kosovës.¹⁶ Rrjedhimisht, qëllimin e synuar, për të ofruar standarde për dialogun e strategjisë dhe ofrimin e sigurisë për publikun në Serbi dhe Kosovë në lidhje me angazhimin e Beogradit për të ruajtur Kosovën në kuadër të Kornizës Kushtetuese të Republikës së Serbisë u hodh poshtë në një dokument të thjeshtë për përdorim brendshëm. Çështja e mospërputhjes në diskursin e Qeverisë së Beogradit në drejtim të pozicionit të saj në Kosovë, në të vërtetë ka provuar të jetë një pengesë për partinë qeverisëse Partia Përparimtare Serbe (SNS) elektorati i së cilës flirton me dy pozicione (ndjenjat historike ndaj Kosovës dhe pragmatizëmit në konstelacionet e reja pas konfliktit të vitit 1999). Kjo është arsyeja pse, Platforma e fundit për Kosovën, e krijuar nga presidenti Tomisllav Nikoliq dhe e dorëzuar në zyrën e kryeministrit Vucic në maj të vitit 2015 shihet si asgjë më shumë, veç se një përpjekje për të mbështetur të dy fraksionet.

Zyrtarë të qeverisë serbe kanë krijuar një numër të pritjeve në lidhje me natyrën e KKS-së dhe kompetencave të saj. Menjëherë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit, KKS ishte një pikë e shitjes për publikun serb në Kosovë, dhe përgjigje për çdo pyetje në lidhje me të ardhmen e komunitetit serb. Këto pritje qëllimisht janë fryrë para dhe gjatë zgjedhjeve lokale me portretizimin e KKS-së si e përafërt me Republika Srpska, me moton zgjedhore "Sot kemi votuar për Srpska, nesër do të ndërtojmë Srpska"¹⁷, dhe me premtimin se KKS do të bëhet një tampon zonë mes Prishtinës dhe

¹³ Deutsche Welle (2013) „Serbija kandidat i vështirë për BE-në“. Shih: <http://www.dw.de/srbija-te%C5%BEak-kandidat-za-eu/a-17323766>

¹⁴ Platforma e re në Kosovë është duke u përgaditur nga kabineti i Presidentit Nikoliq. Është temë e diskutimeve të brendshme përbrenda qeverisë. Ndikimi i Platformës në opinionin publik të serbve, politikat serbe dhe politikat e brendshme mbeten për tu parë.

¹⁵ Të drejta të me tutjeshme janë kërkuar në fushën e edukimit, shëndetësisë, sportit, kulturës, ambientit, planifikimit urban, agrokulture, pylltarisë, peshkimit, gjuetisë, minierave, energjis si dhe politikave ekonomike dhe fiskale, juridiksionit, punëve të brendshme, telekomunikacionit, tregtisë dhe financave.

¹⁶Ejdus, F. (2014) “Marrëveshja e Brukselit dhe interesat nacionale të Serbisë: Një faqe bilanci pozitiv”, Konrad Adenauer Stiftung.

¹⁷BPRG (2015) “Integrimi i serbve në Kosovëpas marrëveshjes së Brukselit”. , fq 37, Shih:<http://balkangroup.org/wp-content/uploads/2015/03/Serb-Integration-Kosovo-19-March-2015.pdf>

komunitetit në veri. Komuniteti serb në veri nuk duket që e ka miratuar këtë shpjegim pasi që kryesisht ka reaguar negativisht ndaj marrëveshjes së Brukselit. Megjithatë, me vazhdimin e procesit pritjet janë minimizuar, ishte e qartë se sipas të gjitha dokumenteve kompetencat zyrtare të KKS-së nuk mund të ngjajnë me kompetencat e besuara të Republika Srpskës.¹⁸ Për zyrtarët në Beograd, KKS duhet të jetë "instrument për kohezionin dhe unitetin e komunitetit serb në Kosovë, si dhe një mekanizëm për fuqizimin e saj me anë të kompetencave dhe lidhjeve politike me Belgradin"¹⁹.

Pozicioni i Beogradit në lidhje me kompetencat në thelb është maksimal. Përveç kompetencave ekzekutive në katër fushat e marrëveshjes: zhvillimin ekonomik, arsimin, shëndetësinë, planifikimin urban dhe rural, pritjet janë që KKS duhet të marrë përsipër disa përgjegjësi të ashtuquajturave institucione paralele, por gjithashtu të ketë kompetencat për të krijuar, agjencitë, institucionet publike dhe kompanitë publike. Siç shpjegohet në raportin e Qeverisë së Serbisë për Zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit, komuniteti pa kompetenca të rëndësishme është i pakuptimtë.

"A duhet që KKS të mbetet pa një rol të përcaktuar qartë në drejtim të ushtrimit kolektiv të kompetencave me rëndësi të ndërsjellë për komunitat anëtare, apo opinioni mbikqyrës në zonat e përcaktuara nga marrëveshja e parë, ekzistenca e KKS-së do të jetë krejtësisht e pakuptimtë për Popullin serb në Kosovë dhe Metohi, dhe se nuk mund të pritët që ajo të mbroj të drejtat e tyre dhe të marrë përsipër detyrimet e përcaktuara nga marrëveshja e parë"²⁰ "Sipas nenit 5 megjithatë, kompetencat e KKS-së mund të rriten nga ana e autoriteteve në Prishtinë. Kjo nënkupton që në të ardhmen Beogradi mund të jetë në gjendje të marrë më shumë kompetenca për KKS-në, ndoshta në këmbim për normalizimin të plotë të marrëdhënieve dypalëshe.²¹ Me referencë në strukturën institucionale Serbia ka kërkuar që KKS të ndërtohet nga organet e zgjedhura drejtpërdrejt, por sipas ekspertëve serbë të intervistuar, kjo mundësi është joreale, për shkak të rezistencës së fortë të Prishtinës ndaj një propozimi të tillë.²² Në Serbi, KKS aktualisht referohet si "një lloj entiteti", përmes të cilit serbët do të qeverisin vetën e tyre në mënyrë autonome nga Prishtina dhe asnjë shpjegim i mëtejshëm nuk është dhënë.²³ Qytetarët e Serbisë nuk e dinë saktësisht se çfarë të presin nga ai, për shkak të mungesës së pamohueshme të informacionit të mjaftueshëm.²⁴

¹⁸Ibidem, Page 48.

¹⁹ FER (2015) "Raporti nga tryeza e rumbullaket në Graçanicë – Decentralizimi dhe komuniteti serb në Kosovë", shih: <http://www.fer.org.rs/sr/news/saopstenja/izvestaj-sa-okruglog-stola-u-gracanici.html>

²⁰ Qeveria e Serbisë, Zyra për Kosovë dhe Metohi (2015), "Raporti i progresit në dialogun në mes Beogradit dhe Prishtinës", fq 6.

²¹ Malazogu, L., Ejodus, F., Niç, M. dhe Żornaczuk, T. (2014) "Integrimi apo Izolimi: Kosova veriore në ngërçin elektoral 2014", CEPI.

²² AKTIV interviews with representatives of civil society, Belgrade, 29 October 2014.

²³ Morina, E. (2014) "Brussels "First Agreement" – A year after".

²⁴ AKTIV intervista me disa përfaqësues të shoqërisë civile, Beograd, 29 tetor 2014.

Për Beogradin zyrtar, është e domosdoshme që bisedimet mbi krijimin e KKS-së të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur. Perceptimi është se, sa më shumë progres në zbatim, nga të dy anët, aq më pak hapsirë lihet për komunitetin që të "konsumoj". Në thelb KKS mund të mbetet një guacë boshe, një formë pa substancë, nëse marrëveshjet e mbetura realizohen para krijimit të KKS-së. Për Beogradin, kjo është arsyeja kryesore e cila qëndron në vonesat për krijimin e komunave plotësisht funksional në veri, zbatimin e plotë të marrëveshjeve për mbrojtjen civile, gjyqësorin, energjishtë, telekomit dhe çmontimin e "Parkut të Paqes". Një pikë kontakti e rëndësishme për zhvillimin e ardhshëm të KKS-së është sistemi i saj i financimit duke i dhënë lidhje të ngushtë financiare mes serbëve të Kosovës dhe atyre të Serbisë. Financimi i punësimit publik në kuadër të sistemit të Serbisë (komunat e përkohshme, kompanitë publike, shërbimin e taksave, arsimin dhe shëndetësisë), ishte i dëmshëm për mbajtjen e paqes sociale, sigurisë dhe serbëve të cilët kanë emigruar në Serbinë qëndrore. Beogradi synon të zgjidhë këtë qështje në të njëjtin nivel me krijimin e KKS-së. Një pritshmëri e ngritur nga Beogradi ndaj komunitetit lokal ishte se askush nuk do të humbas punën e tyre për shkak të integritimit. Ka duku rreth 5.800 punonjës brenda organeve serbe të vetëqeverisjes lokale të cilat ende funksionojnë në Kosovë²⁵. Numri i njerëzve që punojnë në institucionet e tjera shtetërore, dhe të tjerë që varen nga disa lloje të pagës publike apo ndihma e ofruar nga Serbia arrinë në dhjetëra mijëra.

Komunat lokale dhe ministritë nga Prishtina nuk i kanë burimet e nevojshme për të mbajtur numrin e vendeve të punës ekzistuese, prandaj Beogradi dhe vendasit janë duke pritur që KKS të ketë rol në këtë qështje nëpërmjet subvencioneve të vazhdueshme buxhetore dhe financimin transparent. Plani i Zbatimit të Marrëveshjes thotë se i gjithë financimi duhet të bëhet në mënyrë transparente dhe se Serbia duhet të ofrojë një pasqyrë të detajuar. Edhe nëse në përgjithësi është e pranuar që serbët e Kosovës mund të marrin fonde nga Serbia në mënyrë transparente, kjo gjë ka interpretime të ndryshme mbi atë se çfarë do të thotë kjo: Beogradi pohon se Prishtina nuk mund të ndalojë rrjedhjen e parave ose të ndryshojë qëllimin e tyre.²⁶ Sqarimi i kësaj çështjeje do të jetë thelbësor për të kuptuar fuqinë e vërtetë të KKS-së dhe forcën e ndikimit nga Beogradi dhe Prishtina. Është e rëndësishme që flukset financiare nga Serbia të janë më transparente, në mënyrë që të japet mbështetja e duhur për zhvillimin ekonomik të rajonit, si dhe për të zvogëluar shqetësimin e Prishtinës ndaj zhvillimit centrifugal. Për këtë arsye duhet të kryhet auditimi i plotë për punësim publik të tanishëm në kuadër të institucioneve të Serbisë.

Kur është fjala për bazën ligjore të KKS-së, Beogradi pret që Prishtina do të duhet të ndryshojë ligjet aktuale mbi Vetëqeverisjen Lokale, Financat e Pushtetit Lokal, Bashkëpunimit ndër-komunal edhe ndoshta të Kushtetutës. Zyrtarët nga Beogradi thonë se kjo është fryma e marrëveshjes ku që të dy palët rregullojnë kornizën e tyre ligjore

²⁵ BPRG (2015) "Integrimi i serbëve në Kosovë pas marrëveshjes së Brukselit", faqe 18, në dispozicion në: <http://balkangroup.org/wp-content/uploads/2015/03/Serb-Integration-Kosovo-19-March-2015.pdf>

²⁶ Malazogu, L. et al. (2014) "Integrimi apo Izolimi: Kosova veriore në 2014 Limboja Elektorale".

në mënyrë që të akomodojnë dispozitat e miratuara, veçanërisht të krijimit të KKS-së. Siç tha njëri nga zyrtarët serb të angazhuar në procesin e negociatave "në qoftë se ne luftuam në Bruksel për të hequr fjalën ligjet 'ekzistuese' të Kosovës nga marrëveshja, ku është poenta për të pranuar se Komuniteti do të formohet në bazë të ligjeve aktuale"²⁷. "Formulimi Marrëveshja e Brukselit nuk e përmend askund se KKS parashikohet të krijohet në përputhje me "legjislacionin aktual". Përkundrazi, neni 4 i Marrëveshjes i referohet vetëm Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale dhe ligjit të Kosovës si kornizë në të cilën KKS do të ekzistojë. Nëse i shtojmë asaj detyrimin e përshtatjes së kornizës ligjore të parashikuar në Planin e Zbatimit, bëhet absolutisht e qartë se ky është një entitet i cili në natyrën e tij ndryshon nga Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe i cili në mënyrë të pashmangshme kërkon rregullim të kornizës ligjore"²⁸.

Zyrtarët e Serbisë kanë dhënë shpesh garanci për publikun se ata do të punojnë për të siguruar që KKS të jetë sa më e pavarur nga autoritetet e Kosovës sa më shumë që të jetë e mundur. Megjithatë, Beogradi është munduar ta siguroj Prishtinën dhe Brukselin se ai nuk ka ndërmend të jetë përçarës dhe se do të vazhdojë të bashkëpunojë. Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Brukselit, Serbia tashmë ka lëvizur përpara me procesin në mënyrë të konsiderueshme, pavarësisht se këto lëvizje janë bërë kryesisht si reagim ndaj kushteve të përcaktuara nga BE-ja.²⁹ Beogradi ka demonstruar ndryshime në qasjen e vet, për shembull, në mënyrë aktive ka inkurajuar serbët e Kosovës që të marrin pjesë në zgjedhjet lokale të 2013 në

Kosovë, krijimi i vetëqeverisjes lokale, integrimin e policisë dhe mbrojtjes civile, përkundër kundërshtimit të ashpër dhe kritikave nga komuniteti lokal. Beogradi ka qenë në gjendje që të shtyp kritikën në veri përmes kombinimit të masave shtrënguese në elitën ish politike dhe vazhdimin e rrjedhave financiare pa të cilat komuniteti serb në Kosovë nuk do të jetë në gjendje të mbajë veten. Është e mundshme që Beogradi do të vazhdojë me zbatimin e marrëveshjes dhe bisedimeve me Prishtinën, për aq kohë sa ato lëvizje e afrojnë vendin më pranë anëtarësimit në BE.

Pozita e Prishtinës – Së pari ne pajtohemi në çdo gjë dhe pastaj nuk mund të diskutojmë "asgjë"

Para Marrëveshjes së Brukselit Prishtina pa planin e Ahtisarit si një koncesion të madh për komunitetin Serb si dhe ata nuk ishin të vullnetit të mirë të pranojnë delegacionin kompetent të një organi të sapo ishte formuar³⁰. Dështimi i përpjekjeve për të marrë kontrollin mbi Kosovën veriore dhe kalimet me Serbinë qendrore në korrik 2011 si dhe presioni i BE inkurajuan institucionet e Prishtinës të fillojnë bisedimet me Serbinë me qëllim që të arrijnë marrëveshje të përbashkëta rreth integritet të veriut në

²⁷AKTIV intervista me zyrtarët serb, 20 shkurt, Istanbul

²⁸Qeveria e Serbisë Zyra për Kosovë dhe Metohi (2015), "Raport progres për dialogun Beograd Prishtinë", fq 7.

²⁹AKTIV intervistë me përfaqësuesit e shoqërisë civile, Beograd, 29 tetor 2014.

³⁰ Rettman, A. (2013) "Thaqi në Serbi: merri 'forcat' jashtë Kosovës veriore", *EU Vëzhgim*, 17 Janar.

kornizën politike dhe atë ligjore. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit, BE shpërblej Prishtinën për vullnetin lidhur me dialogun duke iniciuar bisedimet e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) me Kosovën më 28 tetor 2013. Kjo u kompletua më 2 maj 2014. MSA u miratua nga Komisioni Evropian në prill të vitit 2015 dhe pritet të nënshkruhet nga Këshilli i Evropës në Qershor.

Pozita e Prishtinës në Asociacionin e Komunave Serbe (AKS)³¹ është minimale duke i dhënë mundësi këtij organi vetëm në rrafshin e hapësirave të përmendura në Nenin 4 të Marrëveshjes. Ky qëndrim është shprehë qartë nga ish kryeministri Z. HashimThaqi, i cili e vlerësoi AKS si OJQ pa ndonjë fuqi të shquar.³² Në disa raste, deklaratat Prishtina zyrtarisht deklaron se AKS – së nuk do ti besohet ndonjë kompetencë ekzekutive apo ndonjë tjetër e deleguar me fuqi të shtuar përpos asaj që është arrite me marrëveshje³³. Kompetencat e shtuara të AKS do të dëmtonin balancën sensitive të autoritetit mes institucioneve lokale dhe atyre qendrore të arritura gjatë procesit të decentralizimit. Kjo do t'i tejkalonte gjitha linjat e kuqe të cilat Prishtina i vë gjatë procesit të decentralizimit dhe do të provokojë opinionin publik Kosovar³⁴. AKS duhet të jetë në përputhshmëri me Ligjin e Kosovës dhe e modeluar sipas Asociacionit ekzistues të komunave kosovare (AKK), një organizatë e përbërë nga përfaqësuesit e komunave lokale kosovare, sipas Ligjit mbi Vetëqeverisjen lokale dhe Ligjit mbi bashkëpunimin ndër – komunal. Draft plani i paraqitur në BE nga qeveria e Kosovës është bazuar në statutin e këtij organi,³⁵ duke konfirmuar prezantimin e AKS-së si një mjet koordinimi. Çështja e financimit të AKS nga Beogradi gjithashtu është shumë sensitive për Prishtinën. Në esencë, Beogradit i lejohet të ofrojë ndihmë financiare dhe teknike duke përfshi edhe personel ekspertësh si dhe pajisje për implementimin e kompetencave komunale, vetëm në mënyrë transparente dhe me paralajmërim³⁶. Megjithatë, një numër i përfaqësuesve të vjetër të qeverisë pohojnë se Beogradi mund të ofrojë përkrahje financiare komunave dhe Asociacionit por jo të paguaj rrogat e punëtorëve të Asociacionit, pasi që nuk ekziston asnjë shtet që do të pranonte shkeljen e sovranitetit si dhe duke vërë në pyetje lojalitetin e të punësuarve në institucione publike të paguar nga Prishtina³⁷. " Në princip Prishtina ka pranuar që të punësuarit në qeveritë komunale Serbe do t'i mbajnë pozitat e tyre (derisa ata merren me kompetence lokale) dhe thjeshtë barten në sistemin e Kosovës. Ata gjithashtu u pajtuan që të gjejnë zgjidhje për serbeët në pozita jo ekuivalente me ato të Kosovës, si ato të

³¹ Kur bisedojmë për qëndrimin e Prishtinës lidhur me themelimin e Komunitetit/Asociacionit të komunave serbe, përdorim shkurtesën AKM/KKM

³² Peci, E. (2013) "NGO Fears 'Republika Srpska' Inside Kosovo", *Balkan Insight*, 12 December.

³³ KoSSev (2015) „Stojanović i Tahiri: Bashkësi e plotfuqishme me ligj ,ose Asociacion jo fuqiplote sipas ligjeve te Kosovës , gjindet në: http://kossev.info/faqa/arkiva/stojanovic_dhe_tahiri_bashkësi_apo_asociacion_/4915

³⁴ BPRG (2015) "Integrimi i serbeve në Kosovë pas Marrëveshjes së Brukselit", fq 37, gjindet në: <http://balkansgroup.org/wp-content/uploads/2015/03/Serb-Integration-Kosovo-19-March-2015.pdf>

³⁵ Malazogu, L. et al. (2014) "Integrim apo Izolim: Kosova Veriore më 2014 Ngerq Zgjedhje".

³⁶ Law no.03/ L-040, Article 30

³⁷ CIG (2015) „Implementimi i Marrëveshjes së Brukselit dhe Prospektet e Integritit Evropian për Kosovën dhe Serbinë“,

shiko:<http://www.cigonline.net/docs/Implementation%20of%20Brussels%20Agreement%20and%20European%20Integration%20Prospects%20for%20Kosovo%20and%20Serbia.pdf>

zyrtarëve të mbrojtjes civile. Zyrtarët Kosovar e vlerësojnë këtë 'frymë' e cila ka të bëjë vetëm me periudhën e tranzicionit dhe vlen vetëm për ata të cilët jetojnë dhe punojnë ndershëm në Kosovë."³⁸. Me qëllim të qartësimit të kësaj çështje dhe zhvillimit kah implementimi i marrëveshjes, Prishtina dhe Beogradi duhet me një kujdes të shtuar t'i qasen fondit të komunitetit Serb në Kosovë, duke pasur parasysh qëndrueshmërinë dhe varësinë e saj ndaj punësimit në sektorin publik, si dhe pasojat që mund të shkaktojë rezoluta e parakohshme e kësaj çështjeje.

Qeveria e Prishtinës kërkon implementim të plotë të marrëveshjes së nënshkruar dhe para saj është e gatshme të negociojë themelimin e AKS- së. "Qëndrimi i Kosovës është se diskutimet lidhur me Asociacionin mund të fillojnë vetëm atëherë kur të plotësohen disa kushte të nevojshme. Këto kushte janë: çmontimi i të gjitha strukturave paralele serbe, implementimi i marrëveshjes për drejtësinë, çmontimi i të ashtuquajturës mbrojtje civile dhe largimin e barrikadës në urën e Mitrovicës"³⁹. Kur bëhet fjalë për zbatimin e marrëveshjes për drejtësinë dhe mbrojtjen civile mund të themi se ka pasur pak progres. Sa i përket "zbatimit të ofensivës", zyrtarët serbë kanë kaluar disa ditë në veri duke bërë presion tek gjyqtarët dhe prokurorët serbë që të aplikojnë për pozita të parapara në marrëveshjen mbi gjyqësorin⁴⁰. Marrëveshja për shuarjen e mbrojtjes civile është nënshkruar më 26 mars, duke parapa integrimin e 483 anëtarëve të ish MC⁴¹.

Kur bëhet fjalë për aprovimin e buxhetit të ri të komunave pas disa muajve vonesë, kemi pasur hapa pozitiv. Shuarja e të ashtuquajturave struktura paralele dhe barrikadës/Parku i Paqes në urë do të jetë shumë më shumë e nevojshme për shkak të sfidave ekonomike dhe atyre të sigurisë që i imponohen komunitetit lokal. Duket se këto procese do të shkojnë paralel me negociatat mbi themelimin e AKS-së. Dështimi për shuarjen e të ashtuquajturave strukturave paralele dhe këmbëngulja e Beogradit për financimin e tyre paraqet një kanosje funksionale dhe simbolike për Prishtinën dhe shkelje të dispozitave të Marrëveshjes së Brukselit. Nga njëra anë, funksionimi i mëtejshëm i këtyre institucioneve nënvlerëson procesin e themelimit të komunave gjithë funksionale dhe punën e kryetarëve të sapo zgjedhur. Zgjedhjet u mbajtën, kryetarët u zgjedhën, asambltetë u formuan, dhe më në fund, buxheti u miratua por komunat veriore ende nuk janë plotësisht funksionale pasi që departamentet kryesore ende nuk ekzistojnë. Nga ana tjetër, Prishtina i sheh strukturat paralele si "një ndërhyrje ilegale" e një shteti të huaj në çështjet e saj e cila edhe më tutje e përshkallëzon opinionin publik të Prishtinës. Sipas analistëve, politikanëve dhe publikut në Prishtinë, një ide është se Beogradi ka fituar më shumë me procesin pasi që mund të zhvillohet më shumë drejt integritetit Evropian, gjersa Kosova ende nuk e ka.

³⁸ BPRG (2015) "Integrimi Serb në Kosovë pas Marrëveshjes së Brukselit", fq 30, shih:

<http://balkansgroup.org/wp-content/uploads/2015/03/Serb-Integration-Kosovo-19-March-2015.pdf>

³⁹ Qeveria e Kosovës (2015), "Implementimi i Marrëveshjes së Brukselit – shteti i lojës", fq 15.

⁴⁰ KoSsev (2015), "biseda e përfunduar e Đuriqit dhe Selakoviqit me gjyqtar dhe prokurorë serb", shih:

http://kossev.info/strana/arhiva/selakovic_u_kosovskoj_mitrovici_razgovara_sa_radnicima_pravosudja/4973

⁴¹ Stakic, I dhe Bjelos, M. (2015), "E ardhmja e mbrojtjes civile në Kosovën veriore"

Përpos qëndrimit të institucioneve, disa studiues dhe politikanë shqiptarë të Kosovës kanë denoncuar efektet destabilizuese që ASM-ja mund të ketë një tërsi të sistemit juridik dhe politik të Kosovës.⁴² Ata nuk e shohin AKS-në si një mjet të integritit të komunitetit serb por më shumë e shohin si një mënyrë të de integritit të Kosovës⁴³. Ekziston një shqetësim se AKS mund të jetë një automjet me tendencë centrifugale që mund të dëmtojë funksionin e Kosovës si shtet dhe të shpie në tensione të shtuara ndër-etnike⁴⁴. Ky qëndrim reflekton në besimin se AKS është i modeluar në Republika Srpska⁴⁵ dhe nga kjo Kosova rrezikohet të bëhet një Bosnje dhe Hercegovinë e re, ku udhëheqësit serb do t'i kenë mjetet për të krijuar një shtet jo funksional. Për të tjerët, AKS mund të dëmtojë integritimin e komunitetit serb në sistemin ligjor të Kosovës dhe pengojnë formimin e një shteti të mirëfillte multi – etnik. “ Është në interes të serbëve që të mos izolohen nga sistemi Kosovar sepse me këtë ata do të shkarkojnë elitën politike nga përgjegjësitë. Do të ishte mirë që serbët të integrohen sa më parë në mënyrë që të mbrojnë interesat e komunitetit të tyre më mirë”. Kritika të ashpra i drejtohen qeverisë së mëparshme si dhe asaj të tashme për pranimin e pakusht në agjendën e BE-së.⁴⁶ Si pasojë, janë përhapur diskurset populiste dhe nacionaliste në tërë Kosovën dhe disa analistë besojnë se ky frustrim dhe rrezik do të vazhdojë të rritet dhe që rezulton në veprime të dhunshme. Mendohet si këto tensione mund të përhapen mes shqiptarëve në Luginën e Preshevës dhe Maqedoni dhe kështu efekti destabilizues do të ndihet përgjatë tërë regjionit.⁴⁷

Përkundër këtyre kritikave, qeveria e Prishtinës siguron përkushtimin e saj për të vazhduar bisedimet me Beogradin si dhe sigurimin e zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit. Pas zgjedhjeve të vitit 2014, bllokimi politik vështirësoi dialogun mes Prishtinës dhe Beogradit si dhe bllokoi zbatimin e Marrëveshjes. Kabineti i ri ka konfirmuar dëshirën e tij për të vazhduar dhe për të shtyrë përpara zhvillimet në këtë fushë. Kjo do të thotë se perspektiva e integritit evropian mbetet qëllim i udhëheqjes politike të Kosovës dhe se BE-ja do të vazhdojë të ushtrojë presion mbi Prishtinën për vazhdimin e bisedimeve me Serbinë dhe për arritjen e një zgjidhje të qëndrueshme për çështjen e veriut të Kosovës.

⁴² Bajrami, A. (2013) “Asociacioni i komunave serbe: nga mjete i integritit deri te shkatëerimi në pregaditjen e zgjedhjeve, , Grup studimesh politike dhe ligjore, n. 5.

⁴³ AKTIV intervista me përfaqësues të shoqërisë civile, Prishtinë, 20 tetor 2014, dhe politikanët kosovar 5 Nëntor 2014.

⁴⁴ Morina, E. (2014) “Bruksel “Marrëveshja e parë” – pas një viti”.

⁴⁵ AKTIV Intervistë me politikan kosovar, Prishtinë, 5 Nëntor 2014.

⁴⁶ Një rol i rëndësishëm luhet nga Levizja Vetevendosje, partia opozitare më aktive. Deklaron se është kundër dialogut me Serbinë dhe avokon për të drejtën e Kosovës për tu bashkuar me Shqipërinë.

⁴⁷ Në luginën e Preshevës (Serbi jugore) dhe Maqedoni jeton një pjesë e madhe e populates shqiptare. Përfaqësuesit e tyre ndonjëher kërkojnë nga Beogradi dhe Shkupi për një autonomi dhe pushtet më të madh. , S Kursani dhe I Deda, I. (2012) “Autonomi për pjesën veriore të Kosovës: Scenario të pashpalosura dhe pasojat rajonale”, KIPRED, seri gazetash politike, n.5.

Pikëpamjet e komunitetit lokal

Një proces teknokratik pa fytyrë njerëzore

Serbët e Kosovës ndajnë disa kritika në lidhje me këshillimin mbi KKS-në dhe rezervimit të prekshëm mbi gjithë procesin e dialogut Prishtinë-Beograd. Shqetësimi kryesor është përjashtimi i komunitetit lokal nga vetë procesi. Një sondazh i kryer nga Ipsos tregon se qytetarët e veriut "janë të vetëdijshëm për dispozitat e Marrëveshjes së Brukselit në një masë shumë të vogël, dhe ata kryesisht fajësojnë autoritetet në Beograd për këtë ... shumica e qytetarëve mendojnë se kjo marrëveshje ka pasur një efekt negativ në jetën e tyre të përditshme⁴⁸". Mungesa e përgjithshme e informatave lidhur me procesin, si dhe fakti se ata po mbahen për më shumë se dy vite në akull të hollë sa i përket formimit të KKS ka shkaktuar frikë, pasiguri, pakënaqësi dhe mos besim mes komunitetit në veri⁴⁹. Një numër i të intervistuarve që morën pjesë në grupet e fokusuar të kryera gjatë hulumtimit tonë kanë deklaruar se qytetarët janë shumë të interesuar për të marrë më shumë informacion lidhur me Marrëveshjen e Brukselit, por ekziston një mungesë e analizave cilësore, raportet e gazetarëve dhe opinione në media,⁵⁰ e cila së bashku me mungesën e përgjithshme e transparencës nga ana e qeverisjes krijon një fotografi mjaft e zymtë. Edhe pse përfaqësuesit e komunave veriore po punojnë në draftin e statutit, popullata shumë pak po informohet lidhur me këtë. Konsultimet teknike të ekipeve menaxhere të caktuara për draftin e statutit të KKS-së paraqiten vetëm në nivel qeveritar gjersa popullata informohet për Marrëveshjen dhe zhvillimet e saj kryesisht nga mbulimi mediatik i ndikuar fuqishëm nga Beogradi.

Vetë procesi është teknokratik, i varur nga ekspertë në grupet punuese dhe negociatat me dyer të mbyllura, dhe plotësisht mungon një dimension njerëzor. Nuk është e qartë për qytetarët kush e zotëron këtë marrëveshje dhe kush janë përfituesit e saj. Ata të gjithë janë dakord se elitat politike dhe ekspertët e grupit punues nuk mund të jenë përfituesit kryesorë, por vetëm qytetar në emër të të cilëve kjo marrëveshje u nënshkrua.

Çdo gjë e lidhur me frikën

Pasiguria dhe pakënaqësia janë emocionet e përhapura në mesin e qytetarëve që kemi intervistuar gjatë fokus grupeve. Shumica kanë deklaruar se ata janë të tradhtuar dhe iu është punuar me mashtrim dhe shpresë se ata do të mbeten nën juridiksionin e autoriteteve në Beograd⁵¹. Tranzicioni drejt institucioneve të reja ka dëshmuar të jetë i vështirë dhe komuniteti mendon se ata janë lënë aktualisht në harresë, duke mos ditur

⁴⁸ KFOS (2015) „Opinione të Serbëve në Kosovën veriore – Mozaik i sfidave dhe shpresave“, fq26.

⁴⁹ Grupe të fokusuar të mbajtura në katër komunat veriore.

⁵⁰ Fokus grup mbajtur në Leposavic dhjetor 26.2014.

⁵¹ “të gjitha shpresat/pritjet tona kah Marrëveshja e Brukselit ose komuniteti I komunave serbe u tradhëtuan na kanë vendosë në fund të fundit nuk dime se ku jemi” – bashkëbisedues në grupin e ZubinPotokut, mbajtur më 27 dhjetor 2014.

se ku të drejtohen dhe cilat institucione t'i shohin si përgjegjëse për shërbimet më elementare. Është një ndjenjë e përhapur e mungesës së perspektivës dhe se bërja e ndonjë plani të ardhshëm është parë si e pakuptimtë pas marrëveshjes së Brukselit⁵². Qytetarët e intervistuar të fokus grupeve nuk i kanë të qarta përfitimet e gjithë procesit.

Shqetësimi mbizotërues i komunitetit serb në veri janë marrëdhëniet e tij në të ardhshmen me Beogradin dhe financimi i KKS-së. Integrimi i plotë pa masa mbrojtëse në ruajtjen e nivelit të shërbimeve të punësimit publik, shëndetësisë dhe arsimit, siguria e rrjeteve sociale dhe subvencionet nga Beogradi mund të shpijnë në përkeqësim serioz të mirëqenies ekonomike të komunitetit dhe rrjedhimisht bëhet problem i madh i sigurisë. Qeveria në Beograd historikisht ka qenë punëdhënësi i instancës së parë dhe të fundit për komunitetin serb në Kosovë. Ajo shpenzon rreth 350 milionë euro në vit⁵³ duke siguruar punësim, shërbime sociale, dhe projekte infrastrukturore për komunitetin serb. Kjo ishte një strategji kryekëput politike që synon mbajtjen e popullatës së mbetur serbe të paprekur dhe parandalimin e migracionit. Pa hyrë në qëndrueshmërinë e kësaj qasjeje, nuk ka pasur masa të marra nga Beogradi apo Prishtina në drejtim të komunitetit lokal për të larguar frikën se procesi i Marrëveshjes së Brukseli nuk do të çojë në humbje masive të vendeve të punës si pasojë e tërheqjes së Beogradit nga Kosova dhe integrimin e institucioneve. Madje edhe qytetarët janë të vetëdijshëm se qeveria në Prishtinë nuk është një gjendje të integrojë gjithë stafin e listave të rrogave të Beogradit në sistem, pasi që shumë pozita në sistemin e kaluar nuk mund të gjejnë vend përkatës në sistemin e Kosovës⁵⁴. Dyshohet se Beogradi do të jetë në gjendje të sjellë fonde në të njëjtën masë dhe sasi sikur që ka bërë gjer më tani. Njëri nga pjesëmarrësit e fokus grupit në Zubin Potok thotë se integrimi në kushte ekonomike do të thotë se 'një sistem ekonomik dominues integrohet në një sistem inferior' duke marrë parasysh se Serbia paguan shumë më shumë për kokë banori se Kosova, në rrejtët e sigurisë sociale, shëndetësi, pakot e shërbimeve sociale etj, çfarë do të jetë nxitja për komunitetin serb që të integrohet?⁵⁵ "Rada Trajković gjithashtu beson se financimi serb në fakt ka ruajtur karakterin multi-etnik të Kosovës" ... pa marrë parasysh çka mendojnë komuniteti ndërkombëtar dhe Prishtina, paguesit e taksave serbe kanë ruajtur multi-etnicitetin e Kosovës për 15 vitet e fundit. Në qoftë se nuk do të ishte Serbia, Kosova nuk do të jetë multi-etnike, dhe në qoftë se ne humbim sisteme

⁵² "disa nga shqetësimet e mia më të mëdha në drejtim të së ardhmes. Aktualisht nuk kemi një të ardhme të sigurt, nuk dime se cka sjellë e ardhmja, thjesht nuk e dimë. Ne nuk dime se në cilin shtet jetojmë. Po të më pyes mua dikush se a- Do të thosha në Serbi, për faktet tregojnë dicka tjetër masi jemi futur në proces, gjë që nuk kemi kërkuar."- bashkëbisedues I Fokus Grupit mbajtur në Zvecan në 17 Janar 2015.

⁵³ BPRG (2015) "Serb integration in Kosovo after the Brussels Agreement", page 30, Available at: <http://balkansgroup.org/wp-content/uploads/2015/03/Serb-Integration-Kosovo-19-March-2015.pdf> BPRG (2015)

⁵⁴ "unë nuk besoj se Prishtina është e gatshme të financojë një numër kaq të madh të punësuarve që kemi ne. ata nuk kanë aq shume të holla në buxhet për një numër kaq të madh të njerëzve. Mendoj për punëtorët në listen e pagave Serbe nëpër komuna, dhe nëse komunat shuhen dhe mbesin pa financim serb, çka do të ndodhë me ta?", bashkëbisedues nga Fokus Grupi i ZubinPotokut.

⁵⁵ Fokus Grupi i ZubinPotokut, mbajtur 27 dhjetor, 2014.

të tilla si kujdesi shëndetësor, arsimit, shërbimet sociale, atëherë ne do të humbasim perspektivën e Kosovës si multietnike, ne do të humbasim perspektivën e mbijetesës së popullsisë serbe në këtë territor.⁵⁶ "

Popullata lokale shpreson se këta punëtorë, që mbetën si tepricë në procesin e tranzicionit të mbylljes institucioneve "paralele", të gjejnë punë përmes KKS-së e cila do të financohet përmes donacioneve të Beogradit të kanalizuar nëpërmjet institucioneve në Prishtinë. Për Prishtinën, ashtu siç është shpjeguar më lartë kjo është e papranueshme pasi që nuk duan të shohin punonjësit publikë duke marrë paga nga shteti tjetër, duke supozuar deficitin në besnikërinë e këtyre punonjësve. Në vazhdim, në qoftë se kjo zgjidhje miratohet atëherë KKS mund të jetë një institucion i mbingarkuar me staf, fillimisht duke shërbyer si një mekanizëm për ruajtjen e paqes sociale. Mbyllja e parakohshme e institucioneve serbe në Kosovë, siç kërkohet nga Prishtina pa zgjidhje të gjetur paraprakisht për punëtorët "tepricë" kjo do ishte një pengesë e madhe në gjithë procesin dhe sfidë për suksesin e gjithë procesit të normalizimit. Të dyja palët duhet të jenë veçanërisht të ndjeshme ndaj çështjes së ndihmës së institucioneve të Beogradit ndaj komunitetit serb në Kosovë, dhe duhet të përpiqen të gjejnë zgjidhje më kreative dhe ndoshta të ndryshojnë disa ligje ekzistuese, të tilla si Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligjit për bashkëpunim ndër-komunal, por gjithashtu të përpiqen të interpretojnë ato më me ndjeshmëri ndaj komunitetit serb në Kosovë. Kjo është gjithashtu e rëndësishme për shkak se ajo mund të përdoret si një shenjë e mirë dhe si një masë në ndërtimin e besimit e miratuar nga Prishtina në drejtim të serbëve të Kosovës. Komuniteti lokal në përgjithësi tregon shenja të mosbesimit ndaj institucioneve në Prishtinë. Shkëputja e Përgjithshme nga proceset dhe perceptimin e Prishtinës zyrtare si të paligjshëm nga viti 2008 ka qenë e rënduar më tej nga diskursi i Prishtinës në natyrën e procesit të integritit pas marrëveshjes së Brukselit e cila është me sa duket e orientuar në drejtim të shtrirjes së sovranitetit dhe integritetit territorial, më tepër përkrahëse se sa e vetëdijshme për bindjet e komunitetit dhe natyra e problemeve të tyre. Duket se Prishtina nuk e njeh frikën dhe pozitën e komunitetit lokal në veri⁵⁷.

